




Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo



Datë: 05.11.2018

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil Administrata Tatimore e Kosovës shpall:

KONKURS I BRENDSHËM(AVANCIM)

Titulli i pozitës: *Zyrtar i Lartë Ligjor (1pozitë)*

Nr. i referencës së pozitës së punës: *LI/050/JP00035085*

Përgjegjësi mbikqyrëse: *Jo*

I raporton: *Udhëheqësit të Divizionit për Përfaqësime Ligjore*

Pozita: *Pozitë e karrierës*

Orari i plotë i punës: *Po*

Koeficienti: *8.5, plus shtesa e aplikuesahme*

Shtylla funksionale: *Mbështetja e Programeve*

Vendi i punës: *Departamenti i Shërbimeve Juridike- Drejtoria e Përgjithshme-Prishtinë*

Qëllimi i vendit të punës:

Përfaqësimi i Administratës Tatimore të Kosovës në konteste të ndryshme pran gjykatave dhe para organeve të tjera administrative si dhe bërjen e interpretimeve juridike lidhur me kontratat, vendimet e ndryshme me aktet tjera legjislative. Zgjerimi i mëtejme I bashkëpunimit të zyrës ligjore me gjykatat, prokurorinë dhe organet e rendit përmes inicimit të ndjekjes penale kundër tatimpaguesve në rast të dyshimit për evazion tatimor apo vepra tjera penale nga sfera e tatimeve si dhe shkëmbimit të informativ me interes të dyanshëm.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Planifikon plane (afatshkurta dhe afatgjata) për çështje që lidhen me pozitën e punës. Ofron asistencë, rekomandon dhe këshillon për çështjet ligjore;
- Përfaqëson ATK – në Procedura përmbartimore në Gjykata dhe Përmbartuesit Privat;
- Ben identifikimin e ligjeve relevante pozitive si dhe formulimin dhe hartimin e rregulloreve të brendshme, merr pjesë në grupe punuese në hartimin e ligjeve dhe akteve nënligjore brenda dhe jashtë ATK-së;
- Me autorizimin e Drejtorit bën përfaqësimin e Administratës Tatimore në procedura të ndryshme gjyqësore dhe pranë organeve tjera shtetërore;
- Mban kontakte me palët tjera brenda ATK-se dhe jep sqarime të nevojshme në kuadër të punëve dhe detyrave që kanë të bëjnë me divizionin për përfaqësime ligjore, si dhe merr pjesë aktive në seancat që organizohen në Drejtorinë e Ankesave ;



- Sipas nevojë përpilon parashtresa të ndryshme për gjykatën (padi, përgjigje në padi, ankesa, kundërshtime, heqje nga padia);
- Në baza të rregullta periodike raporton mbi punët e kryera nga ai tek Menaxheri i Divizionit për Përfaqësim Ligjore;
- Kryen punë tjera nga fushë veprimtaria e Divizionit për Përfaqësim Ligjore të cilat kërkohen nga Udhëheqësi.

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

Që të kryej këtë punë me sukses, një individ duhet të ketë:

- Diplomë universitare dega juridik
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri të mira të legjislacionit tatimor në Kosovë
- Njohuri të thellë profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve ligjore, juridike
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale
- Njohuri të lartë të procedurave tatimore dhe procedura të ankesave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Klinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: www.atk-ks.org tek rubrika e punësimit.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmimeve të kërkuara sipas Shpalljes për rekrutim dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së- në Prishtinë në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionit duhet bashkëngjitur të dhënat biografike për përvojën paraprake dhe të gjitha kopjet e kualifikimeve (diplomave, certifikatave të trajnimeve, dëshmi të njohjes së gjuhëve të huaja dhe përdorimit të kompjuterit).

Vetëm aplikacionet zyrtare të Administratës Tatimore do të pranohen.

Njoftimi i do të jete i hapur për dorëzimin e kërkesave 8 dite nga dita e publikimit 05.11.2018 deri me datën 12.11.2018.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha Komunitetet në Kosovë.

"Komunitet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

Aplikacionet e derguara pas dates së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen.

Per shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatet e perzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen.

Per informata shtesë mund të kontaktoni në numrin e tel. 038/200 34 706 .

